

VENDIM I PËRBASHKËT
PËR
THEMELIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE “M.K.D” Sh.A

Sot, më datë 21/08/2025, në Tiranë, Palët e mëposhtme:

- “KAYO” Sh.A, shoqëri aksionare shtetërore, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS M42216020F, me seli në Rrugën e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori Z. Ardi Veliu;
- “MSSC” Sh.P.K, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L01306040L, me seli në Rrugën Dervish Hima (3 Kullat, Kulla nr. 1), Tiranë, e përfaqësuar nga administratori Z. Robert Gode;

në cilësinë e aksionarëve themelues, bien dakord dhe **VENDOSIN** sa vijon:

1. **Themelimi i Shoqërisë:** Themelohet shoqëria aksionare me emrin “M.K.D” Sh.A sipas kushteve të Marrëveshjes së Aksionarëve të datës 1 Gusht 2025.
2. **Aksionarët Themelues:** Aksionarët themelues zotërojnë aksionet si më poshtë:
 - “KAYO” Sh.A – 700 aksione (20% të kapitalit);
 - “MSSC” Sh.P.K – 2,800 aksione (80% të kapitalit).
3. **Kapitali Themeltar:** Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 3,500,000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, i ndarë në 3,500 (tre mijë e pesëqind) aksione me vlerë nominale 1,000 (një mijë) lekë secila.
4. **Forma Juridike:** Shoqëria do të ketë formën e organizimit **Shoqëri Aksionare (Sh.A)**.
5. **Kohëzgjatja:** Shoqëria do të ketë kohëzgjatje pa afat (të pacaktuar).
6. **Selia:** Selia e shoqërisë është në **Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga Dervish Hima, 3 Kullat, Kulla Nr. 1, Tiranë, Shqipëri**
7. **Objekti i Veprimtarisë:** Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është ai i përcaktuar në **Statutin e Shoqërisë** (sipas draft Statutit bashkëlidhur).
8. **Anëtarët e parë të Këshillit Drejtues janë:**

Ferzilet Osmëni me nr. personal I75609030R

Glevin Dervishi me nr. personal I61024059N

Emiljano Dusha dokument me nr personal H60709042I

Eralda Jahaj me nr personal I85103075S

Fatjon Qamil Murati me nr personal I10513072Q

9. **Statuti i Shoqërisë:** Statuti i shoqërisë “ M.K.D.(Myslym Keta Defence)” Sh.A hartohet në përputhje me ligjin shqiptar dhe mund të nënshkruhet dhe të dorëzohet, në përputhje me paragrafin më poshtë, nga secili përfaqësues i autorizuar.

Pas zgjedhjes nga Këshilli Drejtues, Administratori do të jetë i ngarkuar me procesin e regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe çdo autoriteti përkatës, noteri dhe institucione të tjera përkatëse dhe/ose individ shqiptar. Me qëllim përmbushjen e kompetencave të lartpërmendura, Administratori lartpërmendur ka të drejtë të:

a. dorëzojë dhe pranojë të gjitha dokumentet e nevojshme, përfshirë por jo vetëm Statutin e Shoqërisë, Vendimin e themelimit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, lidhur me qëllim regjistrimin e Shoqërisë, selisë ligjore dhe/ose deklararimin e administratorit në të gjitha organet përkatëse shtetërore, përfshirë por po u kufizuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit; organet tatimore, zyrën e punës, sigurimet shoqërore etj. Hapjen e llogarive bankare të shoqërisë pranë çdo banke të nivelit të dytë etj.

b. Hapë llogari për Shoqërinë në platformën e-Albania dhe tërheqin çdo dokumentacion nga kjo platformë;

c. Në përgjithësi, të kryejë të gjitha ose çdo lloj veprimi të nevojshëm ose të përshtatshëm lidhur me çështjet e përmendura në këtë Vendim dhe dokumentacionin përkatës.

11. **Dispozitë Ligjore:** Shoqëria krijohet dhe do të operojë në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Aksionarët Themelues:

"KAYO" Sh.A – Z. Ardi Veliu

"MSSC" Sh.P.K – Z. Robert Gode

